

ASC-10-0040

Në padinë e

██████████ dhe të tjerëve, ish punonjës të Ndërmarrjes Shoqërore

██████████
të gjithë të përfaqësuar nga ██████████, Kryetari i Shoqatës së Sindikatës

██████████, Prishtinë

Paditësit/Ankuesit

kundër

1 ██████████, Ndërmarrje Shoqërore

Malishevë

2. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Ilir Konushevcij, 8, Prishtinë

Të Paditurit

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, lidhur me ankesën e Paditësve kundër aktvendimit të Trupit Gjykues të DHPGJS-së të datës 16 dhjetor 2009, SCA-09-0027, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 gusht 2010, lëshon këtë

A K T V E N D I M

1. Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.

2. Ankuesit obligohen ta paguajë taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumën prej 90 eurove tek Dhoma e Posaçme.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 16 dhjetor 2009, Trupi Gjyqësor i DHPGJS-së e refuzoi ankesën e Paditësve/Ankuesve e cila ishte parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale të Malishevës, C. nr. 290/06 i lëshuar më 13 dhjetor 2008.

Zyra e Regjistrimit të DHPGJS-së e kishte dërguar aktvendimin e sipërpërmendur të Trupit Gjyqësor tek përfaqësuesi i Paditësve/Ankuesve më 19 dhjetor 2009. Paditësit/Ankuesit parashtruan ankesën më 22 prill 2010.

Më 4 maj 2010, Kolegji i Ankesave i urdhëroi Paditësit/Ankuesit të sqarojnë, ndër çështjet e tjera, kur përfaqësuesi i tyre e pranoi aktvendimin e Trupit Gjyqësor. Në përgjigjen e tyre ndaj urdhrit, Paditësit/Ankuesit njoftuan se ata e kanë pranuar aktvendimin në fjalë më 22 mars 2010.

Më 8 qershor 2010, Kolegji i Ankesave i urdhëroi Paditësit/Ankuesit të sqarojnë se përse pretendohet se ata e kanë pranuar aktvendimin e ankimuar (SCA-09-0027, 16 dhjetor 2009) më 22 mars 2010, edhe pse fletëkthesa tregon se ai ishte pranuar më 19 dhjetor 2009. Gjithashtu kopja e fletëkthesës së lartpërmendur ishte dërguar së bashku me urdhrin tek përfaqësuesi i Paditësve/Ankuesve. Me anë të urdhrit të njëjtë, Paditësve/Ankuesve u ishte kërkuar të paraqesin dëshmi se ata e kanë pranuar aktvendimin e Trupit Gjyqësor vetëm më 22 mars 2010. Paditësit/Ankuesit u përgjigjën ndaj urdhrit duke ritheksuar se ata e kanë pranuar aktvendimin e përmendur më 22 mars 2010. Ata gjithashtu dorëzuan një kopje të fletëkthesës së lëshuar nga Gjykata Komunale e Malishevës dhe kjo e datës 22 mars 2010. Në përgjigjen e tyre, nuk ishte dhënë asnjë deklaratë për sa i përket fletëkthesës së lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të DHPGJS-së dhe e cila ishte dorëzuar tek ata me anë të urdhrit.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e paafatshme dhe prandaj është dashur të hedhet poshtë si e papranueshme.

Në pajtim me Nenin 9.5 të Rregullores (RREG) së UNMIK-ut 2008/4, palët mund të ankohen kundër aktvendimeve/aktgjykimeve të trupit Gjykes tek Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së brenda 30 ditëve nga dërgimi i aktvendimit/aktgjykimit.

Në aktvendimin e ankimuar, Trupi Gjykes ka njoftuar se pala e dëmtuar do të mund të parashtrojë një ankesë kundër aktvendimit brenda afatit prej një muaji nga dita e dërgimit të tij. Edhe pse sipas Nenit 9.5 të RREG së UNMIK-ut 2008/4 të përmendur më lartë, afati kohor për parashtrimin e ankesës është 30 ditë, Paditësit/Ankuesit kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë brenda afatit kohor prej një muaji, pasi që ata do të trajtohen sikur kështilla e dhënë nga Trupi Gjykes ishte e saktë.

Sipas fletëkthesës në dosjen SCA-09-0027 dhe fletëkthesën e lëshuar nga Gjykata Komunale të dorëzuar nga Paditësit/Ankuesit më 6 korrik 2010, duhet të përfundohet se aktvendimi i Trupit Gjykes ishte dërguar dy herë tek përfaqësuesi i Paditësve/Ankuesve. Së pari ishte dorëzuar nga Zyra e Regjistrimit të DHPGJS-së më 19 dhjetor 2009 dhe pastaj për herën e dytë nga Gjykata Komunale e Malishevës më 22 mars 2010. Përfaqësuesi i Paditësve/Ankuesve nuk ka dhënë asnjë deklaratë për sa i përket kopjes së fletëkthesës të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të DHPGJS-së e cila ishte dërguar tek ai së bashku me urdhrin e DHPGJS-së. Fletëkthesa e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të DHPGJS-së vërteton se aktvendimi i Trupit Gjykes ishte dorëzuar tek përfaqësuesi i Paditësve/Ankuesve në datën e cila është e shënjuar aty, domethënë 19 dhjetor 2010. Dërgimi i aktvendimit të Trupit Gjykes tek përfaqësuesi i Paditësve/Ankuesve nga Gjykata Komunale më pastaj më 22 mars 2010 nuk ka asnjë rëndësi ligjore. Periudha kohore për parashtrimin e ankesës llogaritet nga dërgimi i parë i aktvendimit nga organi kompetent për dorëzimin e aktvendimeve tek pala përkatëse. Në të dy përgjigjet e tyre ndaj kolegjit të Ankesave, Paditësit/Ankuesit nuk kanë paraqitur asnjë shpjegim të pranueshëm ligjor se përse ata nuk e kanë parashtruar ankesën brenda periudhës kohore të

përcaktuar në Nenin 9.5 të RREG së UNMIK-ut 2008/4, duke u llogaritur nga dërgimi i parë i aktvendimit.

Edhe po që se periudha më e favorshme kohore se ajo prej një muaji siç nënvizohet në aktvendimin e Trupit Gjykues do të zbatohet këtu, periudha kohore për parashtrimin e ankesës për këtë lëndë ka përfunduar më 19 janar 2010 (e martë) në orën 24:00. Ndërsa ankesa ishte ushtruar më 22 prill 2010, duke përdorur shërbimin e rregullt postar, ankesa është e paafatshme dhe rrjedhimisht është dashur të hedhet poshtë si e papranueshme.

Taksat gjyqësore:

Në bazë të Nenit 57.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6, DHPGJS-ja lëshoi Rregulla Procedurale Shtesë lidhur me Taksat Gjyqësore, në fuqi që nga 10 marsi i vitit 2010. Ato janë si vijon:

'Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 27.11.2008, lidhur me "Tarifat e Taksave Gjyqësore", deklarohet – me specifikimet vijuese – të jetë i zbatueshëm për procedurën gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri tek Neni 10.23 janë – mutatis mutandis – të zbatueshëm për procedurën ankimore para Trupit Gjykues dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, Neni 10.11 gjithashtu është i zbatueshëm për procedurën e cila e drejton ankesën kundër aktvendimeve të shkallës së 2të të Trupit Gjykues.

(...)

Këto Rregulla Procedurale Shtesë hyjnë në fuqi më 10 mars 2010 dhe janë të vlefshme deri më 31 dhjetor 2010.'

Taksat gjyqësore në të dyja shkallët kanë të bëjnë nga njëra anë me tarifën për ushtrimin e parashtresës (parashtresave), dhe nga ana tjetër me tarifën për lëshimin e një aktvendimi (ose aktvendimeve).

Meqë aktvendimi i shkallës së parë ishte lëshuar para datës së hyrjes në fuqi të rregullave të lartpërmendura, këtu do të trajtohen vetëm taksat gjyqësore për procedurën ankimore:

Shuma e tarifës për parashtrimin e ankesës siç përcaktohet nga Neni 10.11 i Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ") është 30 euro.

Neni 10.15 i ADJ-së përcakton se aktvendimi për hedhjen poshtë të padive (si të papranueshme) vetëm gjysma e shumës së tarifës siç thuhet në Nenin 10.1 të ADJ-së (që në parim i bazon taksat gjyqësore në vlerën e padisë) duhet të paguhet, deri në maksimumin prej 30 eurove. Kjo zbatohet në parim gjithashtu për aktvendimet në shkallën e tretë, por sipas Nenit 10.22 të ADJ-së tarifa duhet të jetë dyfish. Taksa gjyqësore maksimale lidhur me aktvendimet e shkallës së tretë për hedhjen poshtë të padive si të papranueshme prandaj është 60 euro.

Vlera e padisë së Paditësve/Ankuesve është mbi 10,000 euro. Prandaj taksa gjyqësore për aktvendimin e shkallës së tretë caktohet në shumën prej 60 euro.

Si rrjedhojë, përfundimisht zbatohen taksat gjyqësore për procedurën ankimore si në vijim:

Tarifa e Taksës Gjyqësore Neni 10.11 (parashtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifa e Taksës Gjyqësore Neni 10.15 i lidhur me 10.22 dhe 10.1 (aktvendimi në shkallën e tretë)	60 Euro
Gjithsejtë	90 Euro

Këto taksa gjyqësore do të barten nga Ankuesit.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it
